



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KUKËS

Nr. 256P Prot

Kukës, 17.5.2024

## NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

### Tema e konsultimit:

“Për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Kukës për vitin 2024”

### Informacion për konsultimin:

Bashkia Kukës, nëpërmjet Drejtorisë së Arsimit Kulturës dhe Sportit, ka paraqitur për miratim “Planin e përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor”. Përmirësimi i shërbimit të arsimit parashkollor është një prej prioriteteve të Bashkisë Kukës. Për rrjedhojë, Këshillit Bashkiak kërkon rekomandimet e sugjerimet tuaja për të evidentuar, njohur e specifikuar nevojat dhe mënyrat e përmirësimit të këtij shërbimi.

### Vendi, koha e konsultimit:

Konsultimi do të organizohet ditën e mërkurë, ora 11<sup>00</sup>, 05.06.2024, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

### Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

#### Nga organizatorët:

Kryetari/Anëtarë të Këshillit Bashkiak/, Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Arsimit, Kulturës dhe Sportit, zv.Kryetari i Bashkisë, Përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit Kulturës e Sportit.

#### Nga të ftuarit:

Përfaqësues të shoqërisë civile, këshillat e prindërve, bordet e kopshteve, etj.

#### Forma e konsultimit:

Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjen komisionit përkatës dhe Këshillin Bashkiak.

Kryetari i Këshillit

Albert MUJA



Page: 1